



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit

SJ-013

Prishtinë, më 22 dhjetor 2017

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2017**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Në fillim, kryetari i njoftoi të pranishmit me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e ish-deputetit Agim Aliu me deputetin Muharrem Nitaj.

Kryetari e ftoi deputetin e ri që ta japë betimin dhe ta nënshkruajë deklaratën e betimit. Deputeti z. Nitaj e dha betimin dhe e nënshkroi deklaratën e betimit.

Më pas, për fjalë u paraqit Avdullah Hoti, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, i cili para deputetëve të Kuvendit e paraqiti një deklaratë lidhur me gjuhën fyese të përdorur nga përfaqësuesi i OVL të UÇK-së për veprimtarët e vrarë të LDK-së dhe kërkoi nga deputetët që ta votojnë deklaratën.

Lidhur me deklaratën e paraqitur nga z. Hoti diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, Bilall Sherifi; në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët Milaim Zeka, Kujtim Shala, Arbër Rexhaj, Zafir Berisha, Haxhi Avdyli, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Ismajl Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim deklaratën e propozuar nga Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 68,
Kundër ----- 1,
Abstenime -----10.

Kuvendi me shumicë votash miratoi këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon gjuhën fyese dhe të urrejtjes të përdorur nga përfaqësuesi i OVL të UÇK-së për vrasjet politike të veprimtarëve të LDK-së.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga institucionet e drejtësisë që urgjentisht të ndërmerren të gjitha masat adekuate që rastet e vrasjeve politike të veprimtarëve të LDK-së të trajtohen me seriozitet, profesionalizëm dhe paanshmëri dhe të marrin dënimin e merituar.
3. Vetëm zbulimi i vrasjeve politike dhe i të gjitha krimeve të tjera të pandriçuara garanton zhvillimin e Kosovës si shtet ku sundon ligji dhe e drejta dhe ku të gjithë qytetarët, pa dallim, ndihen të sigurt.

* * *

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Më pas, kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 diskutuan: Glauk Konjufca dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 101 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim në formë elektronike një nga një amendamentet e propozuara në këtë projektligj. Në ndërkohë kryesimin e seancës e mori nënkryetari Xhavit Haliti si dhe votimi i amendamenteve në vazhdim u realizua me ngritje dore.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 46, 47, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 59, 60.

Amendamenti 7 u miratua me vërejtjet e Lumir Abdixhikut, kryetar i Komisionit Funksional.

Kuvendi i miratoi edhe amendamentet e tjera, si në vijim: amendamentin 30, të propozuar nga deputeti Rexhep Selimi, amendamentin 32 të propozuar nga deputeti Imet Rrahmani, amendamentin 48 të propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu dhe amendamentin 58, të propozuar nga deputetja Time Kadrijaj.

Deputeti Islam Pacolli e tërhoqi amendamentin 42.

Deputeti Armend Zemaj e tërhoqi amendamentin 68.

Deputetja Besa Gaxherri e tërhoqi amendamentin 70.

Deputetja Time Kadrijaj i tërhoqi amendamentet 71 dhe 72.

Deputeti Rasim Selmanaj e tërhoqi amendamentin 78.

Deputeti Hajdar Beqa e tërhoqi amendamentin 84.

Grupi Parlamentar “6+” i tërhoqi amendamentet 85, 86 dhe 87.

Deputeti Enver Hoti i tërhoqi amendamentet 95, 96 dhe 97.

Deputeti Salih Salihu e tërhoqi amendamentin 98.

Grupi Parlamentar Lista serbe e tërhoqi amendamentin 99.

Grupi i deputetëve nga radhët e komunitetit joshumicë e tërhoqi amendamentin 100.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 69, 73, 74, 75, 76, 77, 79, 80, 81, 82, 83, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94 dhe 101.

Në fund, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 59,
Kundër -----16,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 18:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale